ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 051/27
Data. 31.01.22

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Grupi Parlamentar

Komente:

Raporti Konsultativ i Zyrës së Rregullatorit për Energji mbi Shqyrtimin e Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërisë të shërbyer nën FSHU

Raporti i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka analizuar Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji mbi Shqyrtimin e Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërisë të shërbyer nën FSHU dhe Raportin e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar, për periudhën 1 shkurt 2022 – 31 mars 2023.

Bazuar në këto raporte, grupi parlamentar i AAK-së, vlerëson se raporti nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe të qartë përballueshmërinë e tarifave të propozuara, njëkohësisht konsideron se procesi është përcjellur me mangësi të theksuara, në veçanti në tri dimensione:

- E para, nuk reflektojnë në analiza të hollësishme të gjendjes;
- E dyta, nuk reflektojnë vlerësim objektiv mbi procesin;
- E treta, nuk marrin parasysh parashikueshmërinë.

Grupi parlamentar i AAK-së konsideron se:

- Në një situatë të rënduar socio-ekonomike, si refleksion i të ardhurave të ulëta, si dhe ndikimeve zinxhirore të krizave, qoftë shëndetësorë apo në tregje, shtrenjtimi i energjisë elektrike, në masën e propozuar, bëhet i pa përballueshëm për shumicën e familjeve në Republikën e Kosovës;

- Diferencimi i konsumatorëve, në një qasje radikale, konsiderojmë se përveç se është diskriminues, e del jashtë frymës Kushtetuese, është i pa analizuar qartë dhe nuk merr në konsideratë faktorët real, sepse është cenueshmeria socio-ekonomike, e këtyre qytetarëve dhe familjeve;
- Propozimi i ZRrE, duke parallogaritur në "zotimin" për subvencionimin e qeverisë, cenon pasqyrimin e drejtë të tarifave, madje, rrezikon parimet e mbrojtjes nga diskriminimi dhe parimet e ndihmës shtetërore[1].
- Diskriminimi thellohet, duke përjashtuar, qytetarë, grupe etnike apo komuna të caktuara nga përllogaritja e tarifave;
- Përjashtimi i korporatave si konsumatorë të mëdhenj, dhe bartja e barrës tek një kategori e konsumatorëve familjarë, poashtu paraqet elemente të qarta diskriminuese;
- Shqyrtimi i jashtëzakonshëm dhe propozimi i tarifave të pa përballueshme, në mesin e periudhës dimërore, pa reflektuar situatën reale socio-ekonomike dhe duke mos marrë parasysh parashikueshmërinë dhe kohen optimale të tranzicionit, rrezikojnë mirëqenien e qytetarëve dhe familjeve;

Bazuar në çështjet e ngritura më lartë, Grupi Parlamentar i AAK-së kundërshton çmimin e pa përballueshëm të tarifave, duke përfshirë edhe bllok tarifat e propozuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE); dhe

Mbi këto vlerësime, grupi parlamentar i AAK-së, kërkon nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Qeverisë, ta kthejë në rivlerësim të plotë procesin, duke vendosur për objektiva këto elemente:

- Përcaktimin e periudhës objektive për tejkalimin e krizës energjetike;
- Analiza e plotë e procesit, duke reflektuar pasqyrimin real të gjithë faktorëve;
- Përgatitjen e një procesi të harmonizuar dhe gradual, me strategjinë e energjisë dhe procesin e tranzicionit drejt stabilizimi të situatës energjetike, si dhe
- Të ndërtojë strategji dhe plane të qarta për përfshirjen e Komunave (Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok), në sistemin e pagesave dhe inkasimin e energjisë elektrike.

Nr. 31/2022/01

Prishtinë, më 31.01.2022

Besnik Tahiri

Shef i grupit parlamentar të AAK-së

[1] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2760